


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar



Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë", - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.


OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE QARKU KORÇË



Qarku i Korçës ka një sipërfaqe prej 3.711 km². Ai përbëhet nga rrethi i Devollit, rrethi i Kolonjës, rrethi i Korçës dhe rrethi i Pogradecit, me 37 Komuna dhe Bashki përkatësisht: 6 Bashki dhe 31 Komuna. Qyteti i Korçës është qyteti më i rëndësishëm në Qark, i cili është edhe qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Korçë.

Qarku i Korçës kufizohet në verilindje dhe në lindje me Maqedoninë, në jug me Greqinë, në jugperëndim me qarkun e Gjirokastrës, në perëndim me Qarkun e Beratit dhe në veriperëndim me Qarkun e Elbasanit.


Korça përbën një nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë.





Vetë muzeumet e shumta në qytet përshkruajnë aktivitetin kulturor ndër shekuj. Është e mirënjohur shkolla e parë shqipe në këtë qytet që daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917. Edhe pse ndër vite qyteti ka qenë pushtuar disa herë, ndikimet e huaja përbejnë një pjesë të vogël të kulturës korçare.

Ekonomia e qytetit të Korçës i ka themelet e saj në zhvillimin bujqësor, por nuk mund të lihen pa përmendur bizneset e mëdha të qytetit të cilat përfshijnë kryesisht sektorin e ndërtimit civil dhe prodhimin e materialeve të ndërtimit, sektorin ushqimor dhe atë të shërbimeve. Niveli ekonomik i qytetit aktualisht ndodhet në një rritje konstante edhe pse duhet të sigurohet akoma stabiliteti ekonomik sipas standardeve të BE-së.



Turizmi në këtë qytet ka dy pika të rëndësishme e të frekuentuara shpesh nga turistët, fshatrat Voskopojë e Dardha. Përveç klimës malore, me pyje të dendur me pisha e bredha, dhe prezencën e një peisazhi mbresëlënës, turistët mund të gjejnë pjesë nga historia dhe trashëgimia e popullit shqiptar duke filluar nga periudha e sundimit Bizantin. Në Voskopojë gjenden një numër i konsiderueshëm kishash ortodokse dhe manastiresh që i përkasin kësaj periudhe. Gjate dimrit të dy këto fshatra turistike ofrojnë pista dimërore për ski.



1 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011

2 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

	Devoll	Kolonjë	Korçë	Pogradec
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor ¹	1034	344	3737	2689
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar ²	3108	1301	14702	7221
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm ³	1014	554	5068	2939
Përqindja e fëmijëve që kanë braktisur shkollën ⁴	0%	0.19%	0.55%	0%

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Ndryshimet social-ekonomike që kanë ndodhur në dhjetëvjeçarin e fundit janë shoqëruar me problematika të reja shoqërore, të cilat kanë sjellë pasoja në koston shoqërore për individë të pambrojtur, familjet e tyre dhe komunitete të ndryshme.

Shoqëria përballet me dhunën, problemet e shëndetit mendor, rritjen e krimit, përdorimin e drogës dhe të pijeve alkoolike, trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin e fëmijëve dhe përfshirjen tyre në format e këqija të punës.

Në këto kushte një numër fëmijësh jetojnë në kushte të vështira.

Qarku i Korçës në vitin 2010, ka 353.267⁵ banorë dhe 103.847⁶ familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 8900 familje (8.6%) janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-18 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbën 25.5 % të popullsisë (89.967 fëmijë).

Në vitin 2010 në Qarku e Korçës 1 në 7 fëmijë (7.139 fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jeton në familje e cila trajtohet me Ndihmë Ekonomike (NE).

1 Drejtoria Arsimore Rajonale, - Korçë, 2011

2 Ibid;




3 Ibid;

4 Të dhënat primare janë marrë nga Drejtoria Arsimore Rajonale, - Korçë, 2011 dhe përlogaritja e treguesit është bërë nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

5 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bredhshme, Mars 2011

6 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

Varfëria dhe akses i kufizuar në shërbimet shoqërore ka ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e ulët të jetesës së grupeve shoqërore të pa favorizuara ,duke ju mohuar të drejtën për të jetuar me dinjitet dhe të kujdesen për vetveten. Qarku i Korçës ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh nga komunitetet e marginalizuara,për këtë rrjedhje edhe problematikat sociale janë më të mëdha. Lypja, shfrytëzimi, puna në të zezë dhe braktisja shkollore mbetet një nga problemet më të mëdha sidomos për Bashkinë Korçë.



Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Korçës në vitin 2009, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtijshëm.

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Korçë gjendet në:

Rruga: 28 Nentori, godina Ish Gjykata e rrethit

Korçë, Shqipëri

e-mail: observatori_korca@yahoo.com

URL: www.observator.org.al

Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Qarku i Korçës ka një Strategji Rajonale të hartuar në vitin 2006.

